

VALTER MEMISHA

**VËZHGIME LEKSIKORE TE FJALËSI I SHQIPES NË FJALORIN
SHQIP – ANGLISHT (2013) TË P. QESKUT**

Pavli Qesku, këtë fillim shekulli, është hartuesi më i pranishëm në leksikografinë dygjuhëshe anglisht - shqip dhe shqip - anglisht. Ka mbi dy dhjetëvjeçarë që përdoruesi ka në dorë disa vepra të tij, që janë mirëpritur dhe kanë vlera të shumta¹, edhe pse mbartin edhe mangësi që rrjedhin së pari nga koncepte shkencore për fjalën e fjalën shqipe në veçanti. Madje ai mëtoi dhe hyri edhe në fushën e leksikografisë njëgjuhëshe të shqipes, duke hartuar një fjalor shpjegues, të cilin e ka titulluar “Fjalor themelor i gjuhës shqipe”².

Në vitin 2014, P. Qesku vjen para përdoruesit të huaj që kërkon të mësojë shqipen, por edhe para shqipfolësve, me veprën *Fjalor shqip – anglisht* (me 170.000 fjalë)³. Fjalori është fryt i një pune të gjatë dhe të stërlodhshme, e lehtësuar deri diku nga përvoja e fituar nga hartimi dhe botimi prej tij i fjalorëve të mëparshëm.

Vepra duhet vlerësuar së pari për makrostrukturën, për sasinë e lemave apo të fjalëve-titull që për leksikografinë dy-, shumëgjuhëshe dhe patjetër për atë njëgjuhëshe (shpjeguese) të shqipes ka krijuar ngjarje. Për herë të parë, në gjithë historinë e leksikografisë së shqipes, kemi një vepër me një fjalës me 170.000 njësi. Kjo tregon punën e jashtëzakonshme të bërë nga hartuesi i veprës për të gjetur e përzgjedhur fjalën e frazeologjinë shqipe, në një kohë kur gjuha jonë nuk ka akoma një database apo një fjalor “tesaurus”.

Sipas hartuesit të veprës, Fjalori përmban: *fjalë të sferës aktive e pasive, të përdorimit të përditshëm e të stileve të larta të ligjërimit, si dhe vulgarizma e zhargonizma; krahinorizma geqe e toske, arbëreshe, çame e kosovare; terma*

¹ Këtu po përmendim: *Fjalor shqip - anglisht / Albanian- English Dictionary* (45.500 fjalë), EDFA, Tiranë, 1999; *Fjalor anglisht – shqip / English - albanian Dictionary*, (40.000 fjalë), EDFA, Tiranë, 1999; *Fjalor anglisht – shqip / English - albanian Dictionary* (75.000 fjalë), EDFA, Tiranë, 2000; *Fjalor shqip - anglisht / Albanian- English Dictionary* (35.500 fjalë), EDFA, Tiranë, 2000; *Fjalor anglisht – shqip / English - albanian Dictionary* (125.000 fjalë), EDFA, Tiranë, 2002; *Fjalor anglisht – shqip / English - albanian Dictionary* (35.000 fjalë), EDFA, Tiranë, 2002; *Fjalor anglisht – shqip / English - albanian Dictionary* (10.000 fjalë), EDFA, Tiranë, 2004. Shih më gjerë faqen e pasme të veshjes së *Fjalorit shqip-anglisht*, EDFA, Tiranë, 2013.

² P. Qesku, *Fjalor themelor i gjuhës shqipe* (33.500 fjalë, Edhe për shkollarët mbi 14 vjeç; Mbi 10.000 barasvlerës të gegërishtes si dhe krahinorizma arbëreshe, çame e kosovare), EDFA, Tiranë, 2008.

³ P. Qesku, *Fjalor shqip-anglisht*, EDFA, Tiranë, 2013.

shkencorë nga një shumësi fushash; shkurtime e shkurtesa të reja e plaka apo historike; emra gjeografikë me emrat e njerëzve dhe mbiemrat e prejardhur prej tyre; emra nga mitologjia ilire, greko-romake, indiane, nordike, kineze, sllave etj.; mbi 40 mijë sinonime dhe përcjellje të fjalë të ngjashme; shkurtime emrash të përveçëm njerëzish (ku shpesh del qartë prirja për shuarjen e dallimeve midis emrave nga burime fetare të ndryshme si Nik (Nikollë dhe Fisnik), Koli (Nikollë dhe Sokol).⁴

Duke parë këtë spektër të përmbajtjes, edhe pse në ballinë titullohet *Fjalor shqip – anglisht*, vepra del shumë shpesh jashtë konceptit të një fjalori gjuhësor. Vetë autori pohon, se “si shumica e fjalorëve të mëdhenj dygjuhësh, edhe ky ka marrë kahe shpjeguese enciklopedike për fusha të specializuara, që përdoruesit të mos i lindë nevoja që t’i kthehet burimeve të tjera orë e pa kohë”⁵.

Autori ka shfrytëzuar disa burime për hartimin e fjalorit, së pari korpusin leksikor që ka përdorur në fjalorët e mëparshëm. Ai pohon te rubrika “Burime” se ka shfrytëzuar botimet leksikografike të shqipes dhe në krye të listës veçon *Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe*, të hartuar nga A. Dhrimo dhe R. Memushaj⁶, dhe *Fjalorin e Gjuhës Shqipe*, të hartuar nga Mehmet Elezi⁷.

Në hyrje të *Fjalorit shqip – anglisht* (me 170.000 fjalë), 2013, P. Qesku shkruan se “Prej fjalorit Latinisht-Shqip të Frang Bardhit (1635) deri sot fjalësi i shqipes ka dalë ndër mjaft botime si Fjalori i Gjuhës Shqipe – Kostandin Kristoforidhi, 1904, Fjaluer i Rii i Shqypes – Shoqnia Bashkimi, 1908 e, pa u ndalë në botimet ndërmjet, Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, 1980, dhe Fjalori Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe, 2011. Ky i fundit kap cakun maksimal të leksikut të botuar deri sot, me rreth 75000 fjalë. Shqipja del me një fjalës bukur të pasur, të mbledhur e të punuar nga Ali Dhrimo dhe Rami Memushi. Një botim i këtij kalibri do të kishte qenë nder për një akademi. Nëse Mehmet Elezit do t’ia kishte ngjitë dorën dikush që Fjalorin e Gjuhës Shqipe 2006 ta plotësonte me botimet e deriatëhershme e të nxirrte një korpus të shqipes mbarë, ma do mendja se s’do të ngurronte; dhe sot do të kishim një botim të plotë e të denjë.”⁸

Dhe më poshtë ai vazhdon: “Në mungesë të një botimi të tillë, me vjeljet në vite dhe me plotësimet dhe përmirësimet nga Fjalori Drejtshkrimor dhe nga fjalori i Mehmet Elezit, po sjell këtë punë me fjalësin më të plotë të gjuhës sonë deri sot, në një fjalor shqip-anglisht, i bindur se do të mbushë një

⁴ Po aty.

⁵ Po aty.

⁶ A. Dhrimo, R. Memushaj, *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2011.

⁷ M. Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.

⁸ P. Qesku, *Fjalor shqip anglisht*, EDFA, Tiranë, 2013.

zbrazëti, paksëpaku, deri kur publiku ynë dhe institucionet e kulturës dhe shkencës do ta pranojnë nevojën për më shumë e për më mirë”⁹.

Duke parë veprën thjesht nga sasia e njësive leksikore e semantike, vërehet se shqipja ka në përdorim një numër disa herë më të madh njësish leksikore sesa ka në fjalorët e botuar, qofshin këta normativë¹⁰, apo jo të tillë¹¹. Autori ka meritën se ka sjellë me mijëra e mijëra njësi me interes të shumëfishtë, dhe njëherazi, ka treguar pasurinë e shqipes si dhe aftësinë për t’iu përgjigjur me mjetet e veta fjalëformuese pasurisë leksikore, frazeologjike dhe semantike të anglishtes.

Po japim në vijim vetëm një çerdhe njësish që lidhen (motivohen semantikisht dhe morfologjikisht) me emrin *Mendje* (autori jep rreth 185 njësi, nga të cilat pjesa dërrmuese janë të papasqyruara: *për menç, mençar-e, mençëm, i mençëm, mençuni-a, i mençur, mençuri, mençurim, mençurish, mençurohem, mençuroj, i mençuruar, mendaç-e, mendaç, mendaçe, mendak, mendalok, mendar-e, mendar, mendare, mendarak, mendari-a, mendatar, mende, mendeçardak, mendegur, mendegjanë, mendehapët, mendekjamë, mendembarë, mendembushun, mendengulët, mendërisht, mendëtor-e, mendëtor, mendëtoe, mendim, mendimtar-e, mendimtar, mendimtare, mendje, mendjeakrep, mendjeakull, mendjebardhë, mendjebardhësi, mendjecangël, mendjecekët, mendjeçalë, mendjedamë, mendjedjerrë, mendjedritë, mendjeerë, mendjefemër, mendjefëmijë, mendjefjetur, mendjefludur, mendjefryrë, mendjefrytë, mendjefshehtë, mendjefshehtësi, mendjefshehur, mendjeftohtë, mendjeftohtësi, mendjefushë, mendjefyçkë, mendjefyell, mendjefyshtë, mendjegjerë, mendjegjerësi, mendjehapur, mendjehollë, mendjehollësi, mendjehu, mendjehumbur, mendje/keq-keqe, mendjekobure, mendjekotë, mendjekthjellët, mendjekthjellshëm, mendjekthjellësi, mendjekthyer, mendjekulluet, mendjekuçur, mendjelahutë, mendjelanë, mendjelaraskë, mendjelartë, mendjelartësi, mendjelehtë, mendjelehtësi, mendjelehtësisht, mendjelëkundur, mendjelëruar, mendjelig-ë, mendjelig, mendjeligë, mendjeligësi, mendjelis, mendjelleshkë, mendjemadh-e, mendjemadh, mendjemadhe, mendjemadhësi, mendjemarrë, mendjembledhur, mendjembushun, mendje-mendje, mendjemëvete, mendjemirë, mendjemprehtë, mendjemprehtësi, mendjemprehun, mendjemprehur, mendjemykur, mendjenaltë, mendjendritur (mb), mendjendritur-i, mendjendritur-a, mendjendryshkur, mendjengritur, mendjengushtë, mendjengushtësi, mendjepak, mendjepakët, mendjepakufishëm, mendjepjellor, mendjepjellori,*

⁹ Po aty.

¹⁰ Këtu kemi parasysh veprat e hartuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASHSH, *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980; *Fjalori i shqipes së sotme*, 1984 / 2002; *Fjalori i gjuhës shqipe*, 2006 / 2012.

¹¹ M. Elezi, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.

mendjepjerdhur, mendjeplep, mendjeplogët, mendjeplogëti, mendjeprefët, mendjepreftësi, mendjeprishës-e, mendjeprishur, mendjepulë, mendjeqamë, mendjeqykë, mendjerrejshëm, mendjeshëndoshë, mendjeshkathët, mendjeshkathëtësi, mendjeshkrepun, mendjeshkrepje, mendjeshkretë, mendjeshkurtër, mendjeshkurtësi, mendjeshollë, mendjeshterpë, mendjeshtypur, mendjeshumë, mendjetrashë, mendjetrashësi, mendjetrokë, mendjethatë, mendjethellë, mendjethellësi, mendjethi-u, mendjeulët, mendjeveri, mendje/zi-zezë, mendjezi, mendjezezë, mendjezog, mendjezhivë, mendohem, mendoj, mendonem, mendor, mendpak, mendqar, mendsh (luaj mendsh), i mendshëm, mendtak-e, mendtar-e, mendtarisht, mendtretun, mendtore, mendtuer, menduar, i menduar, të menduarit, mendues, mendueshëm, i mendueshëm.

Theksojmë këtu, se autori emrat që shënojnë një frymor mashkull dhe një femër, të krijuar nga substantivimi (emërzimi) i mbiemrave i merr si lema të veçanta (*mendjemadh-e, mendjemadh-i, mendjemadh/e-ja; mendje/zi-zezë, mendjezi, mendjezezë* etj.), një qëndrim i saktë shkencor, sepse kategorialiteti semantik i mbiemrave nuk është njësoj me atë të emrave, ashtu si është i ndryshëm edhe kategorialiteti semantik i emrave sipas gjinisë.

Fjalori ka vlera të shumta pragmatike, sepse autori i ka kapërcyer shumë herë parametrat leksikografikë që lidhen me fjalën si njësi leksikore, dhe aty mund të gjejmë lema që lidhen me onomastikën, toponomastikën, terminologjinë etj., që nuk i përkasin botës shqiptare, duke u kthyer, siç pohon vetë hartuesi i tij, në një fjalor enciklopedik dygjuhësh.

Megjithatë, *Fjalori shqip – anglisht*, 2013 (me 170.000 fjalë), i hartuar nga P. Qesku, krahas këtyre vlerave dhe prurjeve të bollshme, paraqet shumë çështje e dukuri të diskutueshme.

Së pari autori i Fjalorit, nuk përmend askund se ka shfrytëzuar produktin leksikografik njëgjuhësh të shqipes, edhe pse te burimet ka dhënë vepra që janë shumë anësore në tërësinë e produktit shkencor të leksikografisë shqipe njëgjuhëshe e dy-e shumëgjuhëshe. Autori, mbase duke qenë jashtë Shqipërisë, nuk është në brendësi të botimeve dhe të punës institucionale që bëhet në vendin tonë në fushën e leksikografisë.. Në realizimin e disa veprave leksikografike dygjuhëshe, dhe në këtë që kemi në duar, nuk përmend as *Fjalorin e gjuhës shqipe*, 1954, as *Fjalorin e gjuhës shqipe*, 2006, me 48.000 fjalë dhe 5.000 njësi frazeologjike, as projektet (dhe punën e nisur) për hartimin e një fjalori të madh me 100.000 njësi leksikore e frazeologjike.

Gjithashtu, duke ditur se asnjë vepër leksikografike, nuk mund të realizohet sasiorisht dhe cilësisht, nëse nuk mbështetet mbi një kartotekë, i bëjmë me dije autorit të *Fjalorit shqip – anglisht*, 2013, se procesi i kompjuterizimit të Kartotekës së Leksikut të Shqipes ka përfunduar dhe përdoruesit e saj kanë në dorë mbi 6.000.000 skeda të kompjuterizuara si imazh. Nuk na duket e drejtë (fjala më e butë që zgjodhëm) pohimi ironik se

“Nuk di a vazhdon digjitalizimi i premtuar prej vitesh i Kartotekës së Gjuhës Shqipe në Institutin e Gjuhësisë, Tiranë. Shpresoj, me një fije dyshimi, që shënimet në ato tre milionë skeda (kam pasur përshtypjen se janë shtatë milionë) të mos shuhen para se dikush të merret seriozisht me shpëtimin dhe përpunimin e tyre”.

Së dyti, Autori, duke mos qenë leksikograf i mirëfilltë, nuk njeh sa duhet dhe si duhet edhe punën hartuese leksikografike institucionale. Ai bën parapëlqime personale ndaj produktit shkencor leksikografik që është në qarkullim, edhe pse shumica dërrmuese e këtij produkti të parapëlqyer prej tij është hartuar duke shfrytëzuar (dhe vazhdon të shfrytëzojë) produktin shkencor që ka dalë nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë. Fjala vjen, ai nuk ka kërkuar falje që ka shfrytëzuar produktin shkencor të këtij institucioni dhe nuk shpreh as mirënjohje për punën e jashtëzakonshme të bërë në Departamentin e leksikologjisë dhe të leksikografisë për hartimin e fjalorëve shpjegues. Duke mos ditur se *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, 1980, është fjalor i tipit të mesëm (për nga numri i fjalëve, me rreth 41.000 të tilla), ai nuk vlerëson atë çka sjell kjo vepër për fjalësin e shqipes, por atë që nuk ka, duke kërkuar prej saj lëndën që mund të pasqyrohej në një vepër tjetër më të vëllimshme (në një fjalor të tipit të madh). Madje, P. Qesku nuk përmend emrat e hartuesve të Fjalorit, duke kaluar në anonimitet emrat e leksikografëve më në zë të shqipes (kur për të tjerë autorë që kanë shfrytëzuar punën e këtyre leksikografëve, ka vend dhe kohë për t'i paraqitur madje edhe me shkrim të mëshuar me të zeza / bold) dhe i quan “gjashtëmbëdhjetëshja e grupit hartues”.

Së treti, P. Qesku shkruan se “... sot do të kishim një pasqyrë ku e ku më të plotë të leksikut të shqipes, nëse gjashtëmbëdhjetëshja e grupit hartues-redaktues të Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe (1980) do të kishte synuar më gjerë, më lart e më mirë. Për fat të keq, ai grup, ose pjesa e grupit që vijoi përpunimin e këtij fjalori bazë vendosi të shkojë në kahe të kundërt: drejt tkurrjes së lëndës.”¹² Nuk e dimë se për çfarë e ka fjalën ky autor, kur shprehet për “tkurrje të lëndës”. Lexuesi shkencor dhe ai joshkencor, duhet të dijë se në vitin 1976, në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë, filloi puna institucionale për hartimin e *Fjalorit të madh të shqipes* me disa vëllime. Vëllimi i parë u përfundua (madje në vitet 2006-2008 filloi puna për ta rishikuar, përditësuar, e plotësuar këtë vëllim). Për nevoja emergjente, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u vendos që kjo punë të ndërpritej dhe të hartohej një vepër njëvëllimshme dhe e tipit të mesëm. Pra nëse “rrudhja” nënkupton vëllimin me 41.000 njësi leksikore dhe me rreth 7.000 njësi frazeologjike, kjo nuk duhet marrë si mangësi e Fjalorit, por si realizim i kriterëve të paravendosura.

¹² P. Qesku, *Fjalor shqip anglisht*, EDFA, Tiranë, 2013.

Gjithashtu, nuk e dimë nëse P. Qesku e ka fjalën për *Fjalorin e shqipes së sotme*, 1984 / 2002, vepër e cila duhet vlerësuar për zbatimin e kritereve që ka paravendosur redaksia shkencore dhe grupi i hartuesve dhe jo të paragjykohet për “tkurrje të lëndës”. Kjo vepër, edhe pse është hartuar mbi *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, 1980, nuk është një rrudhje mekanike e fjalësit nga 41.000 në 35.000 fjalë tituj. Ajo është vepër e re leksikografike dhe e vlerësuar për prurjet. Megjithatë, i kujtojmë autorit se kur ka hartuar të ashtuquajturin “Fjalor themelor të gjuhës shqipe”¹³, ka shfrytëzuar pa leje institucionale *Fjalorin e shqipes së sotme* dhe në shumë zëra ka plagjiaturë të patjetërsueshme (ka marrë prej tij jo thjesht zëra leksikorë, por edhe strukturat kuptimore të tyre, pa as më të voglin ndryshim). Për këtë çështje kam kumtuar dhe kam shkruar një artikull të veçantë¹⁴.

Së katërti, autori me mëtimin se *Fjalori shqip – anglisht*, 2014 (me 170.000 fjalë) është një fjalor që u shërben atyre që kontaktojnë me gjuhën shqipe në të gjitha variantet e saj (sidomos ato territoriale), pra jo vetëm me variantin standard të saj, ka përfshirë në fjalësin e veprës variante dialektore të cilat e rritin në mënyrë mekanike numrin e njësive. Po përmendim disa të tilla, si:

a. Krahas njësive me trajtë normative të shqipes standarde, ku takohen në ballë të fjalës dy bashkëtingëllore të shurdhëta *shk...*, *shp...*, *sht...* etj. (bashkëtingëllorja e parë, përgjithësisht është parashtesë antonimike), jepen edhe njësi si variante dialektore të toskërishtes, në të cilat grupet e mësipërme kthehen në *çk...*, *çp...*, *çt...* etj.

Po ilustrojmë vetëm me një grup njësish, me ato ku takohet grupi *çk...*: *çkâhit*, *çkalít*, *i çkalshítun çkallavít*, *me u çkallavítë*, *çkamebâhe-ja*, *çkamós*, *çkapistáll*, *me u çkapistállë*, *çkapistállje*, *çkapullóhem*, *çkapullój*, *me çkapullúe*, *me u çkapullúe*, *çkiklím*, *çkiklój*, *me çkiklúe*, *i çkiklúem*, *çkilifíu*, *çkilifíni*, *çkírr*, *i çkírrë*, *me çkírrë*, *çkírrje*, *i çkírrun*, *çkishërím*, *çkishëróhem*, *çkjéptas*, *me çkjepúe*, *çkodifikím*, *çkodifikóhet*, *çkodifikój*, *çkombëtarizím*, *çkombëtarizój*, *çkopsís*, *çkopsít*, *çkoq*, *çkóqem*, *çkoqít*, *çkoqítet*, *çkreh*, *çkréhem*, *çkrif*, *çkrífet*, *çkriflím* *i*, *çkriflón*, *me çkriflúe*, *çkriminalizím*, *çkriminalizóhet*, *me çkúe*, *me u çkúe*, *i çkúem*, *e çkúeme-ja*, *çkujdésem*, *çkujdésje*, *çkurdís*, *çkurdís*, *çkurorëzój*, *çkurorëzóhem*.

b. Krahas njësive me trajtë normative të shqipes standarde jepen edhe me trajtat gjegjëse jo normative në gegërishte. Fjala vjen, jepen fjalët me një **a**

¹³ P. Qesku, *Fjalor themelor i gjuhës shqipe* (33.500 fjalë, Edhe për shkollarët mbi 14 vjeç; Mbi 10.000 barasvlerës të gegërishtes si dhe krahinorizma arbëreshe, çame e kosovare), EDFA, Tiranë, 2008.

¹⁴ V. Memisha, *Për një fjalor të vogël të shqipes standarde*, në “Studime për fjalën shqipe”, Tiranë, 2011 (Kumtesë në Seminarin III Ndërkombëtar të Albanologjisë, Shkup, 2009).

hundore së cilës në shqipen standarde i përgjigjet një *ë*, si *běj* dhe *baj* (*me ba*), *e ëma* dhe *e ama*, *ëndërr* dhe *andërr*, *nantë* dhe *nëntë*, *nantëqind* dhe *nëntëqind* etj. Kjo mbartet dhe çerdhen paradigmatiche fjalëformuese (i *ëndërruar* / i *andërruar*, *ëndërrvramë* / *andërrvramë*; madje në shumë raste nuk është i saktë edhe në paraqitjet dialektore: jep i *andërruar* për i *andrruem* etj.), duke e dyfishuar numrin real të njësive të këtij lloji.

c. Jepen të gjithë mbiemrat prejpesorë, edhe me temën e pjesores në standard dhe me trajtat dialektore/nënstandarde të gegërishtes, si i *qytetëruar* dhe i *qytetnuem* etj.

d. Krahas trajtave normative jepen si lema të veçanta variantet e tyre dialektore, madje të ngushta krahinore, si *mendehapët* për *mendjhapët*, *mendegjanë* për *mendjegjerë*, *qumur* për *qymyr*, *prëndverë* për *pranverë*, *gopzherr* për *gabzherr*, *brryl*, *bryl* për *bërryl*, *ylver* për *ylber*, etj. Njësi të tilla janë me mijëra, duke e rritur ndjeshëm artificialisht numrin prej 170.000 fjalësh.

Së pesti, në fjalor kanë zënë vend qindra e qindra emërime të shkurtuara, si QZSHHC, QZHD etj. dhe një pjesë prej tyre nuk lidhen fare me emërime të pathjeshta të shqipes a të botës shqiptare, por janë thjeshtë përkthime të gjegjëseve të tyre në një gjuhë tjetër.

Së gjashti, me mëtimin për të futur sa më shumë lëndë, autori ka pasqyruar shumë huazime që janë vjelë në mënyrë rastësore, jo sistematike dhe që nuk i përkasin shtresës së huazimeve të shqipes. Kjo tregon edhe një herë konceptin e paqartë të autorit për fjalën në gjuhën amtare. Një njësi mund të jetë e huazuar apo e kalkuar, por jo çdo regjistrim i një njësie të tillë, në një përdorim krejt anësor apo shumë specifik, duhet të zërë vend në leksikun e shqipes dhe prej kësaj të fitojë edhe status leksikografik. Përdorimi në një thënie (apo në disa të tilla) nuk do të thotë se fjala ka fituar qëndrueshmëri dhe është bërë pronë e shqipfolësve. Kjo do të nënkuptonte një hapje të dymës të shqipes ndaj hyrjes së fjalëve të huaja apo një shqyerje të portave të saj, ku çdo fjalë e huaj, e përdorur nga të rinjtë e sotëm si shfaqje e snobizmit, do të përfshihej në leksikun e shqipes.

Së shtati, ashtu si pranon vetë autori i Fjalorit, në vepër kanë zënë vend jo vetëm emrat e njerëzve por edhe shkurtimet e tyre, duke u futur si lema të veçanta: *Skënder* dhe *Neri*, *Grigor* dhe *Gori*, *Manushaqe* dhe *Shaqe*, *Sadete* dhe *Deti* etj. Kjo do të thotë se kemi një shtim numerik artificial të njësive leksikore si fjalë tituj. Nuk po ndalemi këtu, tek parapëlqimet apo përzgjedhjet e emrave. Nëse autori kishte vendosur të pasqyronte gjithë onomastikën e shqipes, atëherë numri i emrave të njerëzve, i dyfishuar përmes shkurtimeve (sepse besoj që të gjithë emrat e njerëzve e kanë një emër zbulues apo një shkurtim), do të rriste me disa dhjetëra mijëra numrin e lemave në fjalor.

Së teti, në vepër kemi edhe shumë hidronime, oronime, toponime etj., që nuk i përkasin vetëm botës së shqiptarit. Por, pasi po i pranojmë këto grupe

njësish si pjesë përbërëse të një fjalori dygjuhësh (por jo si lema të gjuhës shqipe), shtrohet pyetja se cili është kufiri i pasqyrimin të tyre. Po japim për ilustrim grupin e njësive me fjalën *det*. Aty kemi tri emërtime të përgjithshme: *det i brendshëm*, *det i lirë*, *det i mbyllur*, kurse në vazhdimësi kemi emërtime të përveçme toponimesh. Ka edhe asosh që jo vetëm nuk i përkasin shqipes, por besoj se gati 100% e shqiptarëve nuk i kanë dëgjuar asnjëherë në jetën e tyre emrat e tyre, si: Deti Moluka, Deti Peçora, Deti Sibujan, Deti Sulu, Deti Tazman, Deti i Luzonit, Deti i Ohotskut etj.

Autori ka dhënë në *Fjalor* si fjalë të shqipes këto emërtime: *det i brendshëm*, *det i lirë*, *det i mbyllur*, Deti Adriatik, Deti Albor, Deti Arafura, Deti Aral, Deti Balltik, Deti Barenc, Deti Çukçi, Deti Egje, Deti i Arabisë, Deti i Bardhë, Deti i Beringut, Deti i Filipineve, Deti i Groelandës, Deti i Hebrideve, Deti i Japonisë, Deti i Javës, Deti i Jonit, Deti i Karaibeve, Deti i Kinës Lindore, Deti i Kinës së Jugut, Deti i Koraleve, Deti i Kretës, Deti i Kuq, Deti i Labradorit, Deti i Luzonit, Deti i Marmarasë, Deti i Ohotskut, Deti i Samarës, Deti i Siberisë Lindore, Deti i Solomonit, Deti i Timorit, Deti i Vdekur, Deti i Verdhë, Deti i Veriut, Deti i Zi, Deti Irlandez, Deti Kara, Deti Kaspik, Deti Mbretëresha Viktoria, Deti Mesdhe, Deti Mindanao, Deti Moluka, Deti Norvegjez, Deti Peçora, Deti Sibujan, Deti Sulu, Deti Tazman, Deti Tirren, Deti Visajan.

Përsëri shtrohet pyetja: Sa njësi të tjera duhet të shtoheshin? Mos vallë duhet të vinin në fjalor të gjithë detemërtimet, lumemërtimet, malemërtimet, fushemërtimet etj.? Sepse në një formë a në tjetrën, përmes përkthimeve në shqipe nga mbarë kultura botërore, kemi edhe ardhjen në alfabetin e gjuhës sonë të këtyre emërtimeve (por ato nuk janë assesi fjalë të shqipes).

Së nënti, në fjalor kanë zënë vend shumë emërtime të nomenklaturave për fusha të caktuara tematike. Shumë prej tyre janë njësi që nuk i përkasin shqipes, por edhe nëse i përkasin, kjo nuk do të thotë që të futen gjithë emrat e bimëve, të kafshëve, të insekteve, të sendeve etj. në fjalor. Fjala vjen, a do të futnim në fjalor të tillë gjithë emrat e dhenve, të dhive, të lopëve, të kuajve, të qenve etj. që ekzistojnë në Shqipëri (apo në Amerikë, Kanada, Australi, Afrikë e Jugut, Zelandë e re etj., ku flitet anglisht?). Mendoj se jo.

Kështu që numri i njësive në Fjalor është rritur artificialisht me emërtime të pathjeshta të panevojshme ose lehtësisht të zbërthyeshme semantikisht dhe lehtësisht të kuptueshme dhe nga dikush që nuk e njeh shqipen. Po japim katër grupe tematike me emërtime nomenklature (karakteristikë e fjalorëve terminologjikë):

a: art, Galeria e Arteve, objekte arti, dashuri për artin, artet e bukura, artet e zbatuara, gatimi është art, art për art, vepër arti, art bashkëkohor, art dekorativ, art figurativ, art i gatimit, art i qeverisjes, art i të shkruarit, art i zbatuar, art konceptual, art konkret, art modern, art modernist, art nouveau, art

optik, art optik, art pamor, art plastik, art pop, art popullor, art shtëpiak, art ushtarak, art varrimor.

b. arterie, arterie bazilare, arterie buzore, arterie cerebrale, arterie cistike, arterie digjitale, arterie e meningjeve, arterie faciale, arterie femorale, arterie gastrike, arterie hepatike, arterie iliake, arterie karotide, arterie koronare, arterie oftalmike, arterie pankreatike, arterie pulmonare, arterie rektale, arterie temporale, arterie vertebrore.

c. çelës anglez, çelës avarie, çelës buton, çelës dadosh, çelës dinamometrik, çelës fundor, çelës i dritave të shkurtra, çelës i kuadrit, çelës i lëshimit, çelës i ndezjes, çelës i ndriçimit, çelës i regjistrueshëm, çelës i solit, çelës i thjeshtë, çelës pirun, çelës rrotash, çelës tubash, çelës tubor, çelës universal.

d. çelik aciddurues, çelik automatësh, çelik bazik, çelik Besemer, çelik çimentimi, çelik elektroteknik, çelik ferritik, çelik i butë, çelik i derdhur, çelik i farkëtuar, çelik i farkëtueshëm, çelik i fortë, çelik i kalitur, çelik i oksiduar, çelik i pandryshkshëm, çelik i paoksidueshëm, çelik i përlidhur, çelik i pjekur, çelik i qetë, çelik i riardhur, çelik i ruluar, çelik i saldueshëm, çelik i stampuar, çelik i tërhequr, çelik instrumentesh, çelik konstruktesash, çelik konvertori, çelik kushinetash, çelik magnetik, çelik Martin, çelik me karbon, çelik me krom, çelik me nikel, çelik me vanad, çelik ndërtimi, çelik profilat, çelik rapid, çelik special, çelik stampash, çelik standard, çelik sustash, çelik shinash, çelik shpejtprerës, çelik shufër, çelik zjarrdurues.

e. nano-fjalëform. nano-(one bilionth of, ultrasmall / një e miliardta e, shumë shumë e vogël), nanoanalizë, nanoatom, nanobakter, nanobot, nanofosil, nanogram, nanogramcë, nanoherc, nanokompjuter, nanometër, nanonëndetëse, nanomjekësi, nanopërçues, nanoplankton, nanorobot, nanorobotikë, nanosekundë, nanoskopik-e, nanoteknolog-e, nanoteknolog, nanoteknologe, nanoteknologji, nanoteknologjik-e, nanovat, nanovirus.

Së dhjetë, titulli i veprës *Fjalor shqip – anglisht*, mendoj se nuk mund të lejonte që të futeshin si fjalë tituj për fjalësin e shqipes, fjala vjen, edhe shprehje a konstrukte latine që përdoren të gatshme jo vetëm në shqipe por në të gjitha gjuhët (sepse janë ndërkombëtarizma). Kështu, numri i fjalësit të shqipes është rritur në mënyrë artificiale. Po përmendim vetëm një grup njësisht të tilla, si: *ab absurdo* / *ab absúrdo* / [nga absurdja] shpr lt *Ab absurdo* (from the absurd); *ab aeterno* / *ab aetérno* / [që kur s'mbahet mend] shpr lt *Ab aetereno* (from time immemorial); *ab antiquo* / *ab antúkuo* / [që në lashtësi] shpr lt *Ab antiquo* (from ancient times); *ab extra* / *ab ékstra* / [nga burime të jashtme] shpr lt drejt *Ab extra* (external sources; from outside); *ab hinc* / *ab hink* / [këtej e tutje] shpr lt *Ab hinc* (from here on); *ab incunabulis* / *ab inkunábulis* / [që në djep] shpr lt *Ab incunabulis* (from the cradle; from the beginning; from infancy); *ab initio* / *ab ínítio* / [nga fillimi; në fillim] shpr lt *Ab initio* (from the beginning; at fire); *ab intra* / *ab íntra* / [nga brenda] shpr lt *Ab*

infra (from within; from the inside); *ab origine* /ab oríxhine/ [nga burimi] shpr It Ab origine (from the source); *a bene placito* /a béne plaçító/ [sipas dëshirës] shpr It A bene placito (at one's pleasure); *a Deo rex, a rege lex* / a déo reks, a réxhe leks/ [nga perëndia mbreti, nga mbreti ligji] A Deo rex, a rege lex (the king is from God, the laë from the king); *a capite ad calcem* /a kápíte ad kálçem/ [këmbë e kokë] shpr It A capite ad calcem (from head to toe); *a contrario* /a kontrário/ [nga e kundërta] shpr It A contrario (from the opposite); *a cruce salus* /a krúçe sálus/ [shpëtimi (vjen) nga kryqi] shpr It A cruce salus (from the cross comes the salvation); *a capella* /a kapéla/ [vetëm me zë] shpr It muz A capella (the voice only; ãithout instrumental accompaniment); *a fortiori* /a fortióri/ [aq më shumë] shpr It A fortiori (moreover).

Së fundi, autori duhet të ishte treguar më korrekt me punën e të tjerëve dhe të ruante saktësinë e referimeve. Fjala vjen Fjalorin e Gjuhës Shqipe, të hartuar nga M. Elezi, botuar në vitin 2004, e paraqet si të vitit 2006. Madje, për *Fjalorin anglisht-shqip, 2002*, me rreth 120.000 njësi, deklaroi se tashmë është 125.000 njësi, duke rritur me vetëdije numrin e lemave etj.

Ose dihet që vepra e parë në gjuhën shqipe është Meshari i Gjon Buzukut, kurse P. Qesku citon prej kësaj vepre një thënie, por si autor nuk bën Gjon Buzukun, por babanë e tij, Bdekun: "...ensëh dashunit sëh botësë sanëh... Bdek Buzuku".¹⁵

Si përfundim *Fjalori shqip anglisht*, Tiranë, 2013, me rreth 170.000 fjalë është një vepër që duhet vlerësuar për prurjet në të gjithë përbërësit e saj përmbajtjesorë, si në makrostrukturë e në mikrostrukturë. Megjithatë vepra do të kishte një cilësi më të mirë nëse do të ishin mënjeluar shumë e shumë njësi të panevojshme, jofunksionale, që së shumti nuk referojnë tek të shenjuar të veçantë, ndaj dhe nuk shpërfaqin pasuri leksikore të shqipes.

¹⁵ P. Qesku, *Fjalor shqip anglisht*, EDFA, Tiranë, 2013.